



Funded by
the European Union

Përvojat e të Qenët Një i Ri Queer në Kosovë: Vështirësitë dhe Shpresat.

2024

Implementuar nga:



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499
e-mail: info@cel-ks.org
web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Bashkimi Europian. Përmbatja e tij është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Përvojat e të Qënurit Një i Ri Queer në Kosovë:
Vështirësitë dhe Shpresat

Hulumtues

Hera Jakupi, Fjolla Hoxha, & Ornela Gashi

Mentore

Dr. Kaltrina Kelmendi

Universiteti i Prishtinës,
Fakulteti Filozofik,
Departamenti i Psikologjisë.
dhjetor, 2024

Abstrakti

Ky studim ka për qëllim eksplorimin e përvojave të të rinjëve queer në Kosovë, në raport me ballafaqimin me vështirësitë dhe formimin e identitetit. Për të kuptuar rreth përvojave të tyre, studimi përdori dizajn kualitativ narrativ. Të dhënat u raportuan nëpërmes analizës tematike me qasje induktive. Pjesëmarrësit që morën pjesë në studim ishin gjithsej pesë (tre gra, dy burra) që identifikoheshin si queer. Intervista ishte gjysmë e strukturuar dhe i lejoi fleksibilitet pjesëmarrësve për t'i ndarë përvojat e tyre. Analiza e të dhënave solli në pah, përkundër tjerash, të gjeturat se formimi i identitetit është një proces ambiguoze që shpesh fillon nga vetë-urrejtja e përfundon në vetë-pranim. Përveç kësaj, është kuptuar se anëtarët e komuniteteve përjetojnë dhunë dhe stigmë si rezultat i afilacionit me komunitetet LGBTI+, duke sqaruar se procesi i pranimit nga shoqëria ka dallime gjinore. Më tej, është gjetur se Prishtina si kryeqytet është një hapësirë që ofron mundësi për të eksploruar më shumë veten, si dhe mbështetja nga rrethi social lehtëson procesin e rrëfimit. Hulumtimi gjithashtu thekson se një ndër nevojat e komuniteteve është përkrahja institucionale. U dëshmuar që rrjetet sociale kanë kapacitet për përkrahje, por njëkohësisht luajnë edhe rol negativ. Dhe si përfundim, është theksuar aktivizmi dhe aktivizimi shoqëror e individual si mjet përbalues dhe edukativ në lidhje me çështjet e komuniteteve. Studimi ofron një reprezentim të rëndësishëm të përvojave të komuniteteve në një kontekst konservativ ballkanik, siç është Kosova dhe shërben si bazament për studime të mëtejme në fushën e të drejtave të komuniteteve LGBTI+.

Fjalët kyçe: LGBTI+, Eksperiencia Queer, Vështirësitë, Shpresat.

Përmbajtja

• Përvoja e të qenët Queer në Kosovë	6
• Konteksti teorik & shqyrtimi i literaturës	8
• Metodologjia	11
Metodat	11
Mbledhja e të Dhënave	11
Analiza e të dhënave	13
Konsideratat Etike	14
Pohimet refleksive.....	14
• Të gjeturat	16
Ambiguiteti: Nga vetë-urrejtja deri te vetë-pranimi	16
Anëtarët e komuniteteve përjetojnë dhunë dhe stigmë.	18
Lesbikë ≠ Gej: fetishizimi i grave dhe përjashtimi i burrave.	20
Prishtina si një hapësirë që ofron mundësi të shumta për komuniteteve.	22
Mbështetja nga rrethi social si lehtësues i procesit të rrëfimit.	24
Institucionet duhet të përkrahin më shumë komuniteteve.	26
Rrjetet sociale: të mira apo të këqija?	29
Aktiviz(i)mi si mjet edukativ dhe burim i përbaljes	32
Ndryshimi fillon nga vetja: rekomandime	34
• Diskutimi	37
• Referencat	42

Përvoja e të qenët Queer në Kosovë

Përvojat e individëve LGBTI+ në Kosovë janë të formësuara nga një ndërthurje komplekse e përparimit ligjor dhe konservatorizmit shoqëror, duke e vendosur Kosovën si një vend me një vizibilitet në rritje të LGBTI+, por gjithashtu si një mjedis sfidues për ata që identifikohen jashtë normave heteronormative (National Democratic Institute, 2015). Edhe pse Kushtetuta e Kosovës përkrah vlerat progresive evropiane duke ndaluar diskriminimin mbi bazën e orientimit seksual dhe duke ofruar mbrojtje ligjore kundër krimeve të urrejtjes, këto masa shpesh bien ndesh me normat dhe vlerat familjare tradicionale (Kadriu, 2022). Ky kundërshtim pasqyrohet më qartë në Ligjin për Familjen të Kosovës, i cili njih vetëm martesat mes sekseve të kundërta, pavarësisht gjuhës së Kushtetutës që mund të lejonte një qasje ndryshe. Ndryshe nga disa vende të ish-Jugosllavisë, si Kroacia, Sllovenia dhe Mali i Zi, që kanë bërë përparime duke njohur ligjërisht partneritetet e të njëjtit seks, Kosova ende nuk e ka zgjeruar këtë mbrojtje formale për marrëdhëniet e të njëjtit seks (Hajdari et al., 2022).

Këto kundërshtime ligjore kontribuojnë në një klimë shoqërore ku individët LGBTI+ përballen me pengesa të mëdha drejt barazisë dhe pranimit. Aktivizmi për të drejtat LGBTI+ has në kundërshtim të fortë, siç tregohet nga refuzimi i vazhdueshëm i projektit të Kodit Civil—një legjisllacion që synonte të njihnte bashkëjetesën mes sekseve të njëjta, por që u kritikua gjerësisht si një “kërcënim” për strukturën tradicionale të familjes në Kosovë. Përveç fushës ligjore, qëndrimet shoqërore përforcojnë më tej pritshmëritë heteronormative, duke krijuar një ambient ku individët LGBTI+

vazhdojnë të përballen me marginalizim dhe diskriminim. Edhe pse Parada e Krenarisë e përvitshme shënon një pranim të pjeshëm, kosovarët LGBTI+ përjetojnë norma të larta të abuzimit psikologjik (81%) dhe dhunës fizike (29%), duke theksuar ndarjen mes idealeve kushtetuese dhe realiteteve të përditshme (National Democratic Institute, 2015).

Përvoja LGBTI+ në Kosovë karakterizohet gjithashtu nga një luftë për dukshmëri brenda shoqërisë lokale dhe konteksteve ndërkombëtare. Studiues si Mizzi (2014) theksojnë se si heteronormativiteti institucional ndikon edhe në "orientimet para nisjes", që më specifikisht janë punëtori që masin gatishmërinë në degën e zhvillimit ndërkombëtar për ndihmësit ndërkombëtar në Kosovë, shpesh duke përjashtuar perspektivat LGBTI+ dhe duke lënë individët queer të papërgatitur mjaftueshëm. Këto sfida nxjerrin në pah dinamikat shoqërore në Kosovë, ku individët LGBTI+ detyrohen të navigojnë pritshmëritë kulturore me pak mbështetje institucionale. Punimi i Mizzi-t thekson rëndësinë e praktikave gjithëpërfshirëse që njohin diversitetin seksual dhe që shfrytëzojnë faktorët kulturorë dhe shoqërorë që ndikojnë në përvojat e kosovarëve queer.

Konteksti teorik & shqyrtimi i literaturës

Teoria queer, e bazuar në kritikën feministe dhe post-strukturaliste, ofron një kornizë për të shqyrtuar këto përjashtime shoqërore dhe institucionale. Kjo teori sfidon konstrukte binare të gjinisë dhe seksualitetit, duke e konsideruar identitetin si fluid dhe performativ, dhe jo si diçka e ngurtë (De Lauretis, 1991). Ky këndvështrim ndriçon mënyrat se si vlerat heteronormative ndikojnë shoqërinë kosovare dhe se si individët LGBTI+ u rezistojnë këtyre normave duke krijuar hapësira alternative për vetë-shprehje (Watson, 2005). Studime të tjera nga Barrita dhe Wong-Padoongpatt (2021) trajtojnë qëndrueshmërinë brenda komuniteteve queer, duke e konceptuar atë si një formë rezistence ndaj shtypjes sistematike. Ata theksojnë rëndësinë e "familjeve të zgjedhura", që ofrojnë mbështetje sociale dhe emocionale për individët LGBTI+, duke i ndihmuar ata të përballojnë diskriminimin shoqëror dhe të krijojnë një ndjenjë përkatësie në mes të vështirësive.

Studime mbi qëndrueshmërinë, si ai i Asakura-s (2016), e përkufizojnë atë si një proces dinamik nëpërmjet të cilit të rinjtë LGBTI+ zhvillojnë "përvetësim identiteti" duke ndërtuar vetë-agjenci dhe marrëdhënie mbështetëse. Gjetjet e Asakura-s theksojnë se qëndrueshmëria në mesin e të rinjve queer shpesh kultivohet përmes lidhjeve komunitare, aktivizmit kolektiv dhe hapësirave të sigurta që inkurajojnë individët të pranojnë identitetet e margjinalizuara si burim force. Ky këndvështrim është veçanërisht i rëndësishëm në kontekstin kosovar, ku individët queer krijojnë rrjete që mbështesin mirëqenien e tyre dhe kundërshtojnë përjashtimin shoqëror (Asakura, 2016).

Në mënyrë të ngjashme, Estefan dhe Roughley (2013) eksplorojnë qëndrueshmërinë si një proces të formësuar nga përvojat personale dhe ndërveprimet komunitare. Ata përshkruajnë se si individët LGBTI+ ndërtojnë qëndrueshmëri duke naviguar presionet shoqërore dhe duke gjetur mënyra për të integruar identitetet e tyre brenda ndjenjës më të gjerë të vetvetes. Puna e tyre sugjeron që për kosovarët queer, dokumentimi i historive personale të rezistencës dhe qëndrueshmërisë mund të shërbejë jo vetëm si një formë fuqizimi, por gjithashtu të kontribuojë në një narrativë kolektive që sfidon diskriminimin shoqëror dhe promovon pranimin e vetvetes (Estefan & Roughley, 2013).

McDermott et al. (2021) adresojnë sfidat e shëndetit mendor që prekin në mënyrë disproporcionale të rinjtë LGBTI+, të cilët raportojnë norma të larta të depresionit, vetë-lëndimit dhe mendimeve vetëvrasëse krahasuar me bashkëmoshatarët cisgjnorë dhe heteroseksualë. Studimi i McDermott thekson se këto pabarazi në shëndetin mendor burojnë kryesisht nga diskriminimi sistematik dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse, duke apeluar për një qasje të orientuar drejt mjediseve të sigurta dhe afirmuese. Ky këndvështrim nënvizon nevojën urgjente për struktura mbështetëse që adresojnë nevojat unike sociale dhe të shëndetit mendor të individëve LGBTI+ brenda kontekstit kulturor të Kosovës (McDermott et al., 2021).

Për më tepër, studimet nga McCann dhe Brown (2016) ofrojnë një analizë të fokusuar mbi individët transgjnorë, duke theksuar nivelet e larta të diskriminimit që përballen në kujdesin shëndetësor, punësim dhe mjediset shoqërore. Kërkimi i tyre thekson qëndrueshmërinë si një mekanizëm përballues kritik, ku individët transgjnorë zhvillojnë rrjete mbështetëse dhe strategji të vetë-pranimit për të përballuar ndikimet negative të diskriminimit në shëndetin mendor. Ky këndvështrim mbi qëndrueshmërinë thekson rëndësinë e

mjediseve mbështetëse që afirmojnë identitetet transgjimore, duke avokuar për politika gjithëpërfshirëse dhe trajnime në kujdesin shëndetësor për përmirësimin e mirëqenies së individëve transgjimorë (McCann & Brown, 2016).

Gjithashtu, Hajdari et al. (2022) analizojnë kundërshtimet ligjore në Kosovë, duke argumentuar se përjashtimi i marrëdhënieve të të njëjtit seks nga Ligji për Familjen e bën të vazhdueshëm diskriminimin strukturor. Studimi i tyre krahasues me vendet fqinje të Ballkanit tregon se Kosova është mbrapa në njohjen e partneriteteve të të njëjtit seks, çka lë individët LGBTI+ pa mbrojtje themelore ligjore dhe rrit nevojën për aktivizëm. Aktivizmi queer në Kosovë, pra, fokusohet jo vetëm në pranimin shoqëror, por edhe në avokimin për reforma ligjore për të harmonizuar premtimet kushtetuese të vendit me zbatimin e tij praktik (Hajdari et al., 2022).

Në këtë kontekst, ky studim synon të eksplorojë përvojat e përditshme të individëve LGBTI+ në Kosovë, veçanërisht mënyrën se si ata përballojnë një ambient socio-politik të karakterizuar nga kundërshtimet ligjore dhe konservatorizmi kulturor. Duke përdorur analiza cilësore, ky hulumtim do të shqyrtojë narrativat personale, duke kapur sfidat, strategjitë adaptive dhe qëndrueshmërinë e individëve queer brenda peizazhit në ndryshim të Kosovës. Ky studim synon të kontribuojë në një kuptim të thellë të përvojës LGBTI+ kosovare, duke adresuar pyetjen: Cilat janë përvojat e jetës dhe nevojat e individëve queer në Kosovë? Duke përfshirë teorinë queer dhe kornizat e resiliencës, ky hulumtim synon të vendosë bazat për studime dhe rekomandime të mëtejshme politike që pasqyrojnë kompleksitetet e jetës LGBTI+ në Kosovë. Duke dokumentuar narrativat personale të kosovarëve queer, studimi jo vetëm që amplifikon zërat e tyre, por gjithashtu nënvizon nevojën kritike për një kornizë ligjore dhe shoqërore më gjithëpërfshirëse në Kosovë.

Metodologjia

Metodat

Metodologjia narrative është një qasje kërkimore cilësore që përqendrohet në kuptimin se si individët ndërtojnë dhe komunikojnë përvojat e tyre përmes tregimeve. Kjo metodë është veçanërisht e vlefshme për eksplorimin e fenomeneve komplekse sociale, pasi thekson natyrën subjektive të përvojës njerëzore dhe kontekstin ku formohen narrativa (Clandin, 2006).

Ky hulumtim përveq metodologjisë narrative, ka qasje induktive për shkak se ka filluar me observime specifike, që në rastin tonë kanë qenë historitë personale nga intervistat. Prej këtyre intervistave kemi ndërtuar paterne dhe tema, gjë që bën qasjen të jetë induktive. Kjo metodë na dha mundësinë të identifikojmë përvoja, histori dhe aspekte të reja, të cilat japin një kuptim më të thellë dhe më të detajuar për sfidat dhe rezistencën e komunitetit queer në Kosovë. Për më tepër nga to arrijmë në paterne dhe modele që pasurojnë akoma më shumë përmbajtjen e temës.

Mbledhja e të Dhënave

Pjesëmarrësit.

Studimi përfshiu pesë pjesëmarrës, prej tyre mes moshave 20 dhe 30 vjeç, nga disa komuna të Kosovës. Nga pjesëmarrësit tre ishin gra dhe dy ishin burra, të gjithë queer, por me forma të ndryshme të identifikimit:

Njëri nga burrat nuk dëshironte të vendoste ndonjë etiketim mbi veten.

Njëri burrë u identifikua me termin queer.

Nga gratë, njëra u identifikua si biseksuale, një tjetër si queer, dhe tjetra si panseksuale dhe demiseksuale.

Mostra e pjesëmarrësve ishte e qëllimshme në mënyrë që të përfaqësohej një spektër i identiteteve seksuale/dhe gjinore dhe për lojlojshmëri të përvojave queer në Kosovë.

Intervista

Intervistat u zhvilluan në formë gjysmë të strukturuar, duke përdorur pyetje të parapërgatitura dhe të formës së hapur që kanë synuar të eksploronin përvojat personale dhe sfidat e të intervistuarve si individë të komuniteteve LGBTI+ në Kosovë. Kjo na dha mundësinë që të ndjekim temat tona kryesore, por edhe të dëgjojmë histori të reja dhe të papritura nga pjesëmarrësit që jo domosdo ishin të parapara me pyetjet e përgaditura. Pyetjet u ndërtuan për të shpalosur historitë e pjesëmarrësve rreth identitetit të tyre gjinor dhe/ose seksual, si janë përballur me normat kulturore dhe sociale, çfarë roli kanë në komunitetet LGBTI+ dhe si ndihen se mund të kontribuojnë në të duke dhënë rekomandime.

Pjesëmarrësve i'u dha hapësirë për të ndarë ndjenjat e tyre dhe përvojën për ndihmën dhe mbështetjen që kanë marrë nga rrjetet sociale dhe hapësirat e komunitetit, si dhe për të rekomanduar për përmirësime në insitucionet qeveritare për mbështetje më të madhe dhe të vazhdueshme të komunitetit queer. Secila intervistë filloi me një prezantim të qëllimit të hulumtimit dhe një pyetje të formës së hapur që kërkonte nga pjesëmarrësit të prezantonin veten dhe të ndanin historinë e tyre personale. Pasi që procesi i intervistimit përfshinte pyetje të hapura, kjo lejoi fleksibilitet, duke lejuar që bisedat të shkonin në mënyrë të rrjedhshme, ndërkohë që sigurohej përfshirja e temave kryesore që ishin zgjedhur paraprakisht. Një fokus i veçantë u vendos në

krijimin e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës ku pjesëmarrësit ndiheshin të lirë të ndanin historitë e tyre pa frikë që do tëigmatizoheshin apo gjykoheshin. Në fund, intervistat ofruan një pasqyrim të jetës dhe rezistencës queer në Kosovë, duke kontribuar dhe plotësuar qëllimin që kishte paraparë studimi.

Procesi i Intervistimit.

Procesi u zhvillua në disa hapa:

Para intervistimit. Pjesëmarrësve i është dërguar një email me informata që shpjegonte për qëllimin e studimit dhe detaje për pjesëmarrjen. Në këtë email ata gjithashtu u informuan për procedurat e pranueshmërisë për pjesëmarrje dhe për të drejtat e tyre gjatë studimit.

Në ditën e intervistimit. Pjesëmarrësve iu është prezantuar një formular pëlqimi, të cilin mund ta lexonin në formë fizike dhe ta rishqyrtonin. Përt'u siguruar që ata janë të qartë për të drejtat e tyre, ne i lexuam atyre edhe njëherë formularin e pëlqimit dhe morëm miratimin e tyre në formë të shkruar dhe verbal.

Analiza e të dhënave

Analiza tematike e përmbajtjes u aplikua për të analizuar të dhënat. Kjo metodë përfshiu gjetjen e kodeve dhe temave në të dhëna duke identifikuar divergjencat ose elementet e veçanta (Braun & Clarke, 2019). Procesi i kodimit përfshiu disa runde kodimi, siç janë kodimi i hapur, kodimi aksial dhe qasjet selektive. Gjatë kodimit të hapur, autorët nxorën kodet duke lexuar transkriptet disa herë dhe duke u fokusuar në përmendjet që lidhen me përballimin dhe tejkalimin e vështirësive, të lidhura me përvojat e kosovare queer dhe narrativat e tyre. Kodimi është aplikuar përmes softuerit

statistikor Atlas.ti. Në fazën e dytë, temat u organizuan në kategori më të përgjithshme, p.sh., "Ambiguiteti: nga vetë-urrejta deri te vetë-pranimi", "Anëtarët e komunitetit përjetojnë dhunë dhe stigma", "Mbështetja nga rrethi social si lehtësues i procesit të rrëfimit", " Prishtina si një hapësirë që ofron mundësi të shumta për komunitetin ". "Institucionet duhet të përkrahin më shumë komunitetin", "Rrjetet sociale: të mira apo të këqija?", "Aktivizim(i)mi si mjet edukativ dhe burim i përballjes". "Ndryshimi fillon nga vetja: rekomandime". Këto kategori u qartësuan në fazën aksiale me përfshirjen e të tre autoreve dhe mentores, të cilat identifikuan edhe kundër-shembuj dhe integruan temat kryesore në fazën selektive përmes konsensusit.

Konsideratat Etike

Gjatë gjithë studimit, janë respektuar parimet etike të definuara nga American Psychological Association (2017), të cilat mbështeten në mbrojtjen e konfidencialitetit, anonimitetit dhe shmangies së dëmit ndër të tjerash. Informacionet personale të pjesëmarrësve u ruajtën me kujdes, dhe për raportim u përdorën pseudonime për t'u mbrojtur identiteti i tyre. Gjithashtu, ka pasur ndjeshmëri ndaj mirëqenies emocionale të pjesëmarrësve. Atyre iu ka garantuar mundësia për të ndaluar intervistën ose të tërhiqeshin nga studimi në çdo moment, pa asnjë pasojë negative.

Pohimet refleksive

Hera Jakupi, studente e psikologjisë, shpreh se si studimi i një teme të këtillë është tejet i rëndësishëm. Mungesa e literaturës ka qenë një shtysë e fuqishme që ajo të eksplorojë këtë temë. Komunitetet LGBTI+ dhe pjesëtarët e tij janë një

grup i marginalizuar në Kosovë që meritojnë të shprehen si gjithkush tjetër. Ofrimi i një hapësire ku ata mund të lëshojnë zërin e tyre e të mos heshtin që objektiva e saj e parë. Si person vetë jo aq konvencional, eksplorimi i asaj jashta normës është diçka që ka qenë gjithmonë në interes për të. Për të është ndjenjë shumë përmbushëse që të mund të le gjurme në arkivat kosovare me tema si kjo.

Fjolla Hoxha është studente e psikologjisë dhe e interesuar në ngërthimin e shëndetit mendor me fushën e të drejtave të njeriut. Prapavija e saj si aktiviste feministe ka ngjallur interesim në kuptimin e përvojave të personave queer në Kosovë dhe intervenimeve me qëllim të përmirësimit të mirëqenies së komuniteteve të marginalizuara. Ky hulumtim i ka lejuar asaj të kontribuojë në komunitet duke gjeneruar të dhëna nëpërmjet evidences shkencore, një përvojë e cila ka qenë e re për të.

Ky studim për Ornela Gashin ofroi një mundësi për të thelluar kuptimin e saj mbi historitë dhe përvojat e grupeve të marginalizuara dhe të shtypura që jetojnë në një shoqëri konservative. Dëgjimi i historive të pjesëmarrëve, nxiti empati dhe reflektim për përvojat e individëve queer në Kosovë dhe sfidat sociale dhe kulturore me të cilat ata përballen. Ajo që i bëri më shumë përshtypje ishte rezistenca dhe dashuria e personave queer në Kosovë për komunitet e tyre, si dhe përpjekjet e tyre për të krijuar hapësira të sigurt dhe mbështetëse. Ajo beson se ky studim mund të ofrojë shpresë për komunitetin queer në Kosovë, duke treguar se personat queer nuk janë vetëm dhe se komunitetet e tyre po përpiqen vazhdimisht për sigurimin e të drejtave dhe hapësirave të sigurt për ta.

Të gjeturat

Ambiguiteti: Nga vetë-urrejtja deri te vetë-pranimi

Gjatë rrugëtimit të tyre në zbulimin e identitetit seksual dhe/ose gjinor, pjesëmarrësit tregojnë për përvojat e ndërlikuara të ballafaqimit me stigma dhe dhunë, të cilat shpeshherë i kanë shtyrë të mohojnë ndjenjat dhe identitetin e tyre. Disa prej tyre pranojnë se, në përpjekje për të maskuar seksualitetin e tyre dhe për t'u përshtatur me normat shoqërore, kanë përdorur edhe shprehje homofobike, duke u përpjekur të mbrohen nga paragjykimi dhe dhuna e mjedisit që i rrethon.

Dea tregon se si nganjëherë e “pyet veten shumë” dhe e kap një lloj turpi ndaj ndjenjave që ajo ka. Kjo mund të vërehet nga anashkalimi i filmave queer që kanë të bëjnë me lidhje romantike në mes dy vajzave.

“A p'e don ni çikë? It's okay, duje. Po...I think që I won't be able to do that. I will remain in the closet. It's comfortable edhe thjeshtë nuk du, nuk ja kisha bo qeta familjes tem. A p'e sheh, unë e konsideroj dikush tjetër me ba normale, po me ba unë l'm like "no". Shumë ja refuzoj vetit. [...] Edhe filmat queer nuk m'kqyren, except nëse janë Boy Love ato m'kqyren. Nashta është ni lloj shame që e ni nëse i kqyri girls' love. Shoqja jem m'sugjeron "a e kqyrim qeta bashkë" edhe unë i thom "no, it's so cringe" amo n'realitet osht' ni lloj shame që e ni.”

Melosi gjithashtu kur kujton rrugëtimin e tij drejt pranimi të vetes, reflekton në sjelljen homofobike që ka treguar, duke u përpikur të vetëmashtrohet për identitetin e tij të vërtetë e duke përdorur të njejtat shprehje që përdoshin edhe kundret tij: “haramgji”, “fëlliqësirë”, etj. Këto të gjitha kanë qenë një përpjekje që të mos lidhej dhe asocohej me komunitetin

queer dhe që të pranohej nga grupi. Ai u detyrua të konformohej në sjellje “normale” për shkak të ambientit homofobik, gjë që shkaktoi konfuzion për të.

Megjithatë, jo të gjithë pjesëmarrësit kanë përjetuar këtë mohim të brendshëm. Disa tregojnë se, edhe kur nuk kanë qenë plotësisht të sigurt rreth identitetit të tyre seksual, ata kanë pasur një qëndrim të hapur dhe përkrahës, duke mos e parë kurrë si diçka negative. Tendenca për mirëkuptim dhe pranim ndaj të tjerëve i ka ndihmuar që të mos përjetojnë një konflikt të thellë të brendshëm.

Eris tregon se si ka qenë gjithmonë shumë pranuese ndaj komunitetit dhe kohën më të gjatë të jetës së saj e ka parë veten vetëm si një aleate e komunitetit. Ajo tregon që mendimet për të vënë pikëpyetje seksualitetin e saj ishin mjaft të vështira për të u kuptuar, megjithëse ka qenë gjithmonë aleate.

“Unë jam shumë falenderuse që nuk jam afektu prej familjes tem edhe mediat sociale përnime m'kanë informu se jam kanë tepër open, nashta që nuk kom pasë paragjykime kurrë për komunitetin. Me hesht kur ka thonë dikush najsen derogative për komunitetin me siguri e kom bo, po komente homofobike prej meje nuk kanë ardh kurrë.” [Dea]

Sipas pjesëmarrësve, momenti kyç për tejkalimin e këtij konflikti të brendshëm ka qenë vetë-pranimi. Ky hap është përshkruar si një kthesë vendimtare, ku disa e kanë përjetuar si një akt fuqizimi të brendshëm. Pranimi i vërtetë i vetvetes ka qenë jo vetëm një formë çlirimi, por edhe një proces që u ka kthyer kontrollin dhe forcën për të jetuar autentikisht si vetvetja.

Në këtë pjesë, Melosi tregon se si për të rol kyç në tejkalimin e të gjitha vështirësive si gjuha urrejtëse, bullizimi, “daljet hapur” që shkojnë keq, është pranimi i vetes dhe vetëbesimi, lënia

anash e arsytetimeve tek të tjerët se pse jam kështu, përvojat e hershme e po ashtu të mësojnë se si të vetë-mbrohesh duke të të bërë vigjilentë ndaj rrezikut në të cilin mund të ndodhesh.

Në anën tjetër, Eris shpjegon se si ka përdorur vetpranimin për të arritur një përballje me të lehtë me anëtarët e deriatëhershëm të rrethit të saj social të cilët vendosën t'i shkëputin kontaktet me të:

"(...) Seni ma së shumti që më ka menu- që më ka nimu mu është qaj pranimi që ja kom bo vetës d.m.th. përderisa unë jom konë at peace with myself nuk është që...normal që më ka afektu po jo deri në qat masë që une me dashtë me nd'rru tash veten veç që mos me i hupë qita njerëz që i hupa d.m.th. Edhe e menojsha ma shumë kët' aspektin që nëse ata nuk m'dojnë për kush jom unë atëherë nuk kom pse me i lutë me nejtë në jetën tem." [Eris]

Anëtarët e komuniteteve përjetojnë dhunë dhe stigmë.

Përderisa disa pjesëmarrës raportojnë se dhuna fizike nuk ka qenë e pranishme në përvojat e tyre personale, të gjithë janë përballur me stigmën si një dukuri e pandashme e të qenët pjesë e komuniteteve LGBTI+. Ata theksojnë se stigma krijon frikë, duke ndikuar që shumë individë të shmangin përfshirjen në grupe apo aktivitete të komuniteteve, për të mos u shënjestruar nga paragjykimet dhe keqtrajtimet. Stigma shpesh fillon me komentet homofobike nga fëmijët, por mund të përshkallëzohet deri në forma të dhunës fizike. Ata përmendin raste të vandalizimit të hapësirave si Bubble, një vend që shërben si simbol i përkatësisë queer, dhe të kafiterive të tjera të cilat janë targetuar si "queer-friendly." Melosi pëshkruan periudhën e fëmijërisë dhe adoleshencës si një periudhë jo të lehtë pasi që është "ndjerë gjithmonë

ndryshe nga djemtë e mahallës dhe në shkollë, dhe djemtë në familje, apo ndryshe nga djemtë që shihen si stereotipikisht 'djalë'. Fakti që të tjerët e kanë vërejtur këtë, e ka vështirësuar procesin e zbulimit të identitetit të tij, ku termet derogative, bullizuese, gjuha e urrejtjes, homofobike e deri te dhuna fizike, e kanë mbyllur atë në vete duke e detyruar atë të vesh siç e shpreh edhe ai "petkun e heteroseksualitetit".

Eris ndihet me fat që është një person "straight passing", që mundet të kalojë lirshëm si një grua straight dhe potencon vështirësitë që kanë të tjerët që vetëm se kanë karakteristika më tipike për personat LGBTI+. Edhe për të megjithatë ka gjëra që nuk mund t'i bëj ashtu siç do, për shembull të shprehë dashurinë haptazi në publik qoftë në mënyrë fizike apo edhe vetëm me fjalë.

Sipas Marigonës ka shumë kafiteri në Prishtinë që janë vandalizuar, kërcënuar apo mbyllur atëherë kur kanë filluar të njihen si vend ku mbledhen personat queer. Sa për klientët queer ajo thotë se është dashur të rinë vigjilent në çdo moment për ndonjë kërcënim të papritur.

Gjithashtu, ata theksojnë se gjuha homofobike është një përvojë e zakonshme, duke treguar se siguria dhe përkrahja janë të përziara me kërcënime dhe diskriminim të vazhdueshëm. Ata vënë në dukje përdorimin e gjuhës denigruese ndaj komuniteteve, duke i paralelizuar individët queer me figura politike të diskredituara si Vuçiq ose duke i përshkruar si "devijues" nga rruga e Zotit apo si persona me sëmundje mendore. Këto narracione diskriminuese e bëjnë veçanërisht të vështirë diskutimin e hapur në rrethe si universiteti, familja apo shoqëria. Për pjesëmarrësit, çdo diskutim në mbështetje të komuniteteve shpesh perceptohet nga të tjerët si një shenjë e të qenët vetë pjesë e komunitetit, më shumë sesa një angazhim si aktivist.

"M'vjen tepër ron, se nuk du komuniteti LGBTI+ me u asocu me

qasi njerëz, ai [Vuçiq] është kriminel, i përket një shteti gjenocidal, t'jena të qartë për këtë pjesë. Personat LGBTI+ janë njerëzit ma kind që unë i njoh, I swear to god, unë kam friends që janë LGBTI+ edhe janë ma kind sesa straight people. Nashta që e dijna qysh o m'u kanë pjesë e një komuniteti që kanë tepër paragjykime, edhe menoj që qajo na ka bo ma kind edhe thjeshtë i menojna njerëzit si qenie njerëzore dhe jo veç si target me i gjujt.” [Dea]

Procesin e diskutimit dhe kontaktin me gjuhë të urrejtjes Besniku e sheh si të parehatshëm, pasi debatet e tilla shpesh eskalojnë në argumente denigruese, sesa në diskutime të mirëfillta të bazuara në respekt reciprok. Kur flet për gjuhën e urrejtjes, atë nuk e sheh si mjet i drejtuar specifikisht ndaj komuniteteve LGBTI+, por si sjellje e rrënjëzuar në kulturën shqiptare që në parim është shtypëse ndaj të gjitha komuniteteve të konsideruara si jo-normative. Edhe pse sulme direkte nuk ka pasur, ai e përshkruan ndjesinë e këtyre debateve si ‘kërcënuese’ për zbulim jokonsensual të identitetit.

“Njo prej problemeve ma të këqija që i kom përjetu, ka pasë raste ku une meshkujve ju dufsha me i thonë që jom straight edhe jo lezbike, po u dufke me i thonë që jom straight se kur e mirrshin vesh që jom- mu m’pëlqejnë femrat, t’kqyrin me ni far syni sikur ‘a muj me ta ndrru menjen’ ose ‘aa kisha pasë qejf me të pa’ ose... osht’ qaq... t’shtin me u ndi në rrezik [...]” [Marigona]

Lesbique ≠ Gej: fetishizimi i grave dhe përjashtimi i burrave.

Pjesëmarrësit vërejnë se pranimi i personave queer nga shoqëria është ndarë në mënyrë të pabarabartë, duke reflektuar mbi stereotipet dhe objektifikimin seksual. Gratë

queer janë parë si më të pranueshme, kryesisht për shkak të seksualizimit të tyre. Shumë shpesh, ato perceptohen si figura që nxisin eksitim seksual përmes eksplorimeve alternative, siç janë përvojat në treshe. Kjo qasje reduktuese është përhapur nga të dy gjinitë, por veçanërisht nga burrat heteroseksualë, duke e bazuar pranimin e tyre të fantazitë seksuale, më shumë sesa të respektimi të identitetit të tyre.

"Menoj që janë ma shumë accepting towards lesbians se ndaj gay people. [...] P.sh. e njoh ni person që ka pasë shame ndaj burrave gej, edhe menoj që thjesht ja prish atë konceptin e burrërisë. Edhe ni kolege, i dashuri i vet ka thonë nuk e kom probleme që unë edhe shoqja jem jena bashkë, po problemin e kom të burrat gej." [Dea]

Për Marigonën nuk janë vetëm burrat që e bëjnë të ndjehej të objektifikuar. Ka pasur raste në jetën e saj kur gra që nuk kanë qenë shumë të vetëdijshme për seksualitetin e tyre shfrytëzuan atë si një 'eksperiment' duke supozuar që ajo është gjithmonë e gatshme aty për aty për këto fantazi. Në anën tjetër, burrat queer përballen me një nivel më të lartë refuzimi dhe stigmatizimi. Ata shpesh shihen si kërcënim tek burrat heteroseksualë, të cilët ndihen të pasigurt ose të shqetësuar nga ideja e të qenët objekt i vëmendjes së tyre, edhe kur kjo vëmendje nuk ekziston.

"Ni sen që unë shumë besoj që o' kaq lehtë e pranume prej çikave është që, po foli prej perspektivën e të qenët queer si burrë, si djalë, është nashta që jena prej t'paktëve burra që nuk nihen si prey për ta. You feel safe me ni dhomë, me ni queer guy, se e din që nuk e ka ni intention për ty. Pse është kaq zor për djemtë me pranë being gay, e jo being lesbian, osht' sexual fantasy, t'paktën prej menimit tem. P.sh. që unë shpesh e diskutoj edhe e menoj sa lehtë është seeing two

*guys kiss i shtin me vjell djemtë, amo seeing two girls kiss thjeshtë kontribuon në fantazitë e tyre të maniakitetit seksual, të paktën prej perspektivës tem. Shumë e fetishizojnë këtë pjesën e të qenët lesbike. [...] Straight guys përnime kaniherë nuk nihen safe me nejt në të njejtën dhomë me gay guys. Pse? Se qaty osht' the only moment që e shohin veten si f*cking prey. Se mo nuk e kanë the upper hand [...] po jonë tu fol tash për diçka që janë në të njejtin nivel [fizikisht], edhe thjeshtë nuk nihen rehat. Është veç me queer guys, që straight guys nihen qysh ni femën nihet prej djemve.”*
[Besniku]

Një temë që del nga biseda me Marigonën në lidhje me familjen është fakti që edhe pse familja e saj ishin më liberale me të, ata mbanin standarde më të rrepta me njërin nga kusherinjtë e saj që identifikohesh si burrë gej. Kjo mund të jetë rezultat i pritshmërive për t’i përmbushur rolet gjinore, që ndonjëherë dijnë të jenë më të ashpra për burrat.

Këto perceptime tregojnë për një dinamikë të ndërlikuar dhe të pabarabartë të pranimit shoqëror, ku qëndrimet ndaj personave queer varen më shumë nga paragjykimet dhe stereotipet seksuale sesa nga një mirëkuptim apo respekt për identitetin e tyre autentik. Kjo krijon një ambient që jo vetëm që e ndan komunitetin queer sipas gjinisë, por edhe thëllon stigmën dhe marginalizimin e tyre.

Prishtina si një hapësirë që ofron mundësi të shumta për komunitetet.

Pjesëmarrësit që nuk kanë jetuar në Prishtinë e kanë përshkruar ardhjen në kryeqytet si një pikë kthese në jetën e tyre. Ata e përjetojnë këtë hap si një mundësi për t’u ekspozuar më shumë ndaj komuniteteve LGBTI+ dhe për të ndjerë një përkrahje që shpesh mungon në qytetet prej

nga vijnë. Për shumë prej tyre, Prishtina paraqet një hapësirë më gjithëpërfshirëse ku mund të gjejnë përkrahje përmes rrjeteve sociale, organizatave joqeveritare dhe hapësirave si kafiteritë që shërbejnë si qendra komunitare.

Duke qenë e ardhur nga një qytet tjetër i Kosovës, Dea tregon për forcën që e ka gjetur kur ka ardhur në Prishtinë, fillimisht për studime e më pas për punë. Ajo krahason të dy vendbanimet:

“Prishtinën e kom merak për shumë sene, s’osht’ veç që jetoj vetë. E kom gjetë veten, e kom gjet dashninë e jetës, e kom gjet profesionin, kom pa ma shumë njerëz queer, ma shumë stil, ma shumë liri për me kon kush jom. Kur unë dal atje nuk nihna as e lirë. P.sh. tash është shumë n’rregull, at peace a din, jam unë, muj me shku në Bubble edhe nuk m’njeh kërkush. Qekjo menoj që t’nimon shumë se nuk t’njeh kërkush.” [Dea]

Besniku tregon edhe se si ekspozimi ndaj kulturës së kryeqytetit ia ka lehtësuar përballimet me komente homofobike, duke ia ofruar atij hapësirën për të mbrojtur komunitetet pa u targetuar direkt.

“Krejt e bon kryeqyteti; çdo herë senet ndodhin knej, se njerëzit grupohen ma lehtë me interesa të përbashkëta. Krejt u kanë mas shkollës të mesme, në fakultet. Fillon me pa njerëz pak ma shumë, fillon me u diskutu si temë pak ma shumë, nashta tjetra është që fillojna me u rrit mentalisht pak ma shumë, edhe e sheh që ‘kadal se paska edhe tjerë’. [...] Tash ka vene kogjo; ki kafe t’mira, ki bars t’mirë, ka OJQ që mirren specifikisht, osht’ CEL-i, Dylberizmi është ni platformë kogjo nice, edhe plotë të tjerë që mujnë me mbledh komunitetin.” [Besniku]

Melosi e përshkruan fakulltetin për të cilin ka ardhur në Prishtinë si një hapësirë të sigurtë ku ngadalë ka gjetur një rreth të ngushtë, i cili e ka ndihmuar të fillojë të eksplorojë identitetin e tij dhe kjo ka qenë një " thyerje e akullit" për të. Ai tregon se si realiteti i njejtë nuk është në pjesën tjetër të vendit, dhe konsideron se hapësirat e sigurta në Prishtinë i marrim si të "mirëqena", sepse "Kosova është gjithçka jashta Prishtinës", dhe dalja në terren e ka konfirmuar sa ndryshe jetojnë personat queer jashtë Prishtinës dhe në veçanti personat queer në vende rurale, që shprehin përvoja të vështira me të qenët queer dhe mungesën e hapësirave të sigurta.

Mbështetja nga rrethi social si lehtësues i procesit të rrëfimit.

Pjesëmarrësit raportojnë kryesisht përvoja pozitive gjatë procesit të daljes haptazi përpara shoqërisë dhe familjarëve. Ata theksojnë se ky ka qenë një proces i menduar mirë, ku zgjedhja e personave të besuar për të ndarë këtë pjesë të identitetit të tyre ka qenë thelbësore për të shmangur situata të ndërlikuara apo të pakëndshme. Për disa, rrëfimi i orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor ka qenë pothuajse i panevojshëm, pasi miqtë apo familjarët e tyre tashmë e dinin dhe i/e kishin pranuar në heshtje.

Melosi tregon se si shumë dalje shkuan mirë për shkak të rrethit që ai kishte formuar gjatë viteve në fakultet, ku të gjithë e kishin pritur mirë sepse siç thotë edhe ai, në komunitetin queer ka një energji që të tjerë që janë pjesë; shpesh e dijnë që je pjesë e komunitetit para se t'a kuptosh ti për veten, gjë që e lehtëson edhe rrëfimin.

Dea, në anën tjetër kur reflekton mbi këtë eksperiencë shprehet se "e kom gjet personin e duhur me ja thonë për herë t'parë" pasi që motra të cilës i tregoi së pari e priti atë si

diçka normale dhe jo me ndonjë nam të madh. Gjatë udhëtimit të saj që prej pandemisë—kur e ka pranuar identitetin e saj—ajo ia ka zbuluar identitetin seksual edhe disa miqve të tjerë.

Besniku, tregon se si rrëfimi shpesh ka ndodhur natyrshëm dhe për të ka qenë një moment pozitiv kur shoqëria e tij kanë deklaruar se nuk ka nevojë të ndjejë nevojën për të dalur haptazi.

"Shpesh herë veç ka ardh [rrëfimi] pëgjatë kohës, p.sh. ke kalu kohë mjaftushëm bashkë, me shoqni që mo thjeshtë e kanë njoftë personalitetin ton edhe diqysh e teston shumë, e teston ujin, edhe tani qayr a je tu u ni safe me kallxu ose diçka. Ka pasë shoqni që kanë punu nëpër organizata, jon kanë njerëz pak ma progresiv, që e kanë diskutu qet' temë, amo kështu fully coming out, nah, se është identitet në zbulim. Është p.sh. shoqni që ke kalu kohë të mjaftushëm si ti, si tjerët që e dijnë, edhe e sheh që "okej, he's kinda fruity" edhe kur t'e merr vesh ma direkt, është tani çdo herë reagimi "okej, pse je tu m'kallxu". [Besniku]

Marigona gjithashtu merr kohë të shprehet që familja e saj e ngushtë ka qenë më e pranueshme dhe nuk i kanë ndjekur idealet heteronormative si rrethi social. Familja këtë "lajm" nuk e kanë marur si surprizë. Ata madje ishin të çuditur se si Marigona kishte vendosur të shprehej kaq "vonë". Kjo mbështetje nga familjarët e saj e bënë që edhe Marigona vetë të mundohet t'i ofrojë personave të tjerë queer mbështetje sa më të madhe:

"Kur jom rritë... domethënë unë krejtë shokëve i kam thonë 'hej a din i'm- jom queer' domethënë nuk u konë ni term specifik që kom ditë me përdorë edhe në fakt motrat e mija veç kanë thonë 'qitash e more vesh a?' 'okej nuk është lajm' edhe i kom

tregu edhe mamit edhe ajo u konë shumë e konfuzume ka thonë a din pse po më tregon sikur...e kanë ditë..." [Marigona]

Eris tregon se si eksplorimi i identitetit të saj i ka marrë afër 7 muaj, dhe në këtë periudhë, personi që iu është gjendur më së afërti ka qenë gruaja e vëllait të saj. Ajo kishte rol të rëndësishëm në jetën e Eris dhe për këtë arsyeje ishte edhe personi i parë që Eris iu kishte rrëfyer rreth seksualitetit. Shoqëria vetë queer e Erisit gjithashtu kishin kontribut të madh që Eris të ndihej sa do pak rahat me persona specifik. Megjithatë, jo të gjitha përvojat kanë qenë pozitive. Disa pjesëmarrës përmendin situata të vështira. Për Eris, për shembull, megjithë mbështetjen e disave nuk ka nënkuptuar një rrugëtim të lehtë me pranimin e vetes sepse edhe pse kishte mbështetje nga disa, ajo edhe kishte humbur shoqëri për shkak të rrëfimit. Një dalje hapur që ka shkuar keq për Melosin, ka qenë me shokun e apartamentit, i cili ka dalur nga banesa pas shpalesjes së identitetit të tij seksual. Pavarësisht kësaj, shumica e pjesëmarrësve kanë gjetur përkrahje në rrugëtimin e tyre. Në ato raste kur përkrahja mungonte, ata kanë zgjedhur të mos të ndajnë këtë pjesë të jetës së tyre, duke ruajtur integritetin dhe sigurinë personale.

Institucionet duhet të përkrahin më shumë komunitetet.

Pjesëmarrësit theksojnë rëndësinë e përkrahjes institucionale dhe të figurave publike me autoritet për të promovuar dhe edukuar publikun rreth të qenët LGBTI+ në Kosovë. Ata përmendin se veprime simbolike, si pjesëmarrja e liderëve shtetërorë dhe komunalë në paradë, fjalimi publik i Mimoza Kusari-Lilës për mbështetjen e vëllait të saj homoseksual, dhe përpjekjet për njohjen ligjore të martesave të njëjtës gjini, janë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

"Menoj që thjeshtë ni fjalë të mjafton ti me u ni okej, ose jo okej, po të paktën mos me u ba burim i nervozës tande për qat' ditë. T'kish thon' [Albin Kurti] "s'po du me komentu" unë e kisha marr si kundër. Po përderisa unë e kom ni me ni intervistë që ia kanë ba pytjen "të drejtat e personave LGBTI+" ky ka thonë "e drejtë e tyre njerëzore". E ka konsideru shumë normale, e drejtë vëlla, për me ekzistu. Ti nëse nuk e lejon ni person gay me vepru qata që po don me vepru, ti je tu ja nal të drejtën me ekzistu." [Dea]

Marigona gjithashtu vendos rëndësinë te aktivizimi i personave në fuqi në lidhje me temat queer. Ajo thotë që kur politikanët janë pjesë aktive e paradave apo kampanjave për fuqizimin e komuniteteve, ajo ndjen një farë sigurie dhe optimizmi për ndryshim në të ardhmen.

Megjithatë, mungesa e përkrahjes institucionale reflektohet qartë në raste si miratimi i Kodit Civil, që përfaqëson një dështim në njohjen e të drejtave të komuniteteve LGBTI+. Pjesëmarrësit vënë në dukje se kodi duhet të reflektojë drejtësi dhe mbështetje, pa qenë e nevojshme të përdoren teknika të "mashtimeve ligjore" për t'u shmangur përgjegjësi.

"Për mu çka u desht me u bo, është që Kodi Civil u desht me u bo, edhe pikë, pa pasë nevojë për diskutim, pa pasë nevojë për kurgjo hiq. Don me ndërru gjininë në letërnjoftim se s'po nihesh rehat në qat gjini që t'u ka caktu, edhe veç e bon. Amo është temë pak ma e fellë, se prapë menoj që hala s'e kem kapacitetin si institucione me i menaxhu qeto sene. I feel proud për ekzistencën tem, amo në momentin kur you don't have the urge and the need me u identifiku edhe me u shpjegu si queer, qajo është kulmi i shoqnisë." [Besniku]

Përveç kësaj, ata kritikojnë mungesën e theksuar të përkrahjes në institucionet kryesore të vendit. Sistemi shëndetësor është i paarritshëm për personat queer, sidomos për ata që dëshirojnë të kalojnë në operime gjini-afirmuese, duke qenë se procedura të tilla nuk ekzistojnë fare. Arsimi gjithashtu injoron nevojat e këtyre komuniteteve – nuk flitet për edukim seksual dhe profesorët shpesh injorojnë ose shmangin totalisht këto çështje. Mungesa e përkrahjes është evidente edhe në ministritë e ndryshme, me një përjashtim të Ministrisë së Kulturës, e cila është perceptuar si disi më miqësore ndaj komuniteteve LGBTI+. Kjo mungesë mbështetjeje, e kombinuar me homofobinë institucionale, krijon një sfidë të thellë për komunitetet LGBTI+ në Kosovë, duke e lënë përkrahjen simbolike të pamjaftueshme për të adresuar nevojat e tyre reale.

“[Sistemet shtetërore] kanë qenë jashtëzakonisht homofobike, shumica janë akoma ashtu, në veçanti Ministria e Arsimit e cila përveç bullizmit, mbjell edhe urrejtje për grupet e marginalizuara, është thjesht një “sistem diskriminues”. Sistemi i mjeksisë është shumë stigmatizues, duke e bërë shumë të vështirë të bësh një testim të thjeshtë seksual pa u qortuar nga stafi ose pa u gjykuar nga ta. [...] Komuna gjithashtu nuk shfaq ndonjë qëndrim ndryshe ku në fakt nga një përvojë personale që kam pasur, kanë përqeshur dhe diskriminuar. [...] Për dallim nga këto sisteme, ajo e Ministrisë së Kulturës dhe Sportit është shumë mbështetëse dhe e gatshme për mbështetjen e personave queer të këtyre fushave. Edhe kryetari i komunës së Prishtinës dhe kryeministri e bëjnë më “okej” dhe janë bashkëpunues me aktivitetet që organizohen nga komunitetet LGBTI+, siç kanë qenë edhe paradat e organizuara për Muajin e Krenarisë. Policia gjithashtu është duke treguar progres në këtë aspekt, me ofrimin e departamentit të veçantë për

shqetësimet që mund të kenë personat queer.” [Melosi]

“Sistemi i arsimit në fakt nuk e trajton hiq si temë. Ka debate që literalisht ja nisin nëse e ki ni profesor ma fetar, pak ma mendje-mbyllt’, edhe tani janë nja 2-3 studenta pak ma të pranushëm, amo në instanca taman zyrtare, menoq që veç i ikin si temë. Njejtë e vëren me institucione zyrtare, se veç nuk kanë çahre prej kushtetutës [...] Na tash jemi tu ju afru zgjedhjeve edhe cilado parti që del publikisht që e mbështet, ajo meniherë e hup nifarë elektorali që janë pak ma konservativ.” [Besniku]

Rrjetet sociale: të mira apo të këqija?

Pjesëmarrësit theksojnë rëndësinë e rrjeteve sociale si mjete që kanë kontribuar ndjeshëm në rritjen e dukshmërisë së komuniteteve LGBTI+. Për shumë prej tyre, rrjetet sociale kanë shërbyer jo vetëm si platforma për të eksploruar identitetin personal, por edhe si një mënyrë për të lehtësuar procesin e daljes haptazi pa pasur nevojë për ballafaqime të drejtpërdrejta. Pjesëmarrësit theksojnë gjithashtu se këto hapësira kanë ndihmuar në gjetjen e komunitetit të tyre, shpesh të fshehur përmes llogarive pseudonime, duke krijuar mbështetje të ndërsjellë gjatë sfidave personale dhe sociale. Anë pozitive Eris thekson të jetë vetëdijësimi që i ndodh rinisë nga konsumimi i mediave me reprezentim të duhur si dhe ofrimi i një hapësire më gjithëpërfshirëse ku ka raste që personat vetë kanë zbuluar identitetin e tyre seksual dhe gjinor shkaku i këtyre mediave.

Dea ia ka pranuar vetes atraksionin që e ndjen ndaj vajzave gjatë pandemisë, ku rrjetet sociale morrën hov, në veçanti Tiktoku. Ekspozimi ndaj një mediumi i cili ofronte dukshmëri për personat queer i ndihmoi Deas t’a pranojë identitetin e saj dhe të rrëfehej për herë të parë te e motra.

"Mediat sociale menoj që ndihmojnë, i ofrojnë platformë komunitetit me u shpreh, me i tregu edhe të tjerëve që nuk je vetë, e shyqyr që folet edhe osht' e qasshme, edhe shyqyr që jetojmë me ni demokraci ku ekziston fjala e lirë dhe liria e veprimt, munesh me bo çka të don. Free will, thank god!"
[Dea]

Për Melosin, dalja nga dollapi filloi online dhe ishte pak më e lehtë sepse mungonte ai komunikimi "face-to-face" dhe ishte një përgaditje e mirë për të dalur haptazi edhe para shoqërisë në SHBA ku kishte shkuar gjatë studimeve, e cila ishte shumë pranuese duke krijuar disa nga përvojat e para pozitive të coming-out.

Një mbështetje e madhe për Marigonën përveq familjes ka qenë edhe vetë komuniteti në internet. Ajo shprehet se personat queer e kanë internetin si një hapësirë të sigurtë për të qenë vetëvetja duke përdorur "burner accounts" dhe "aliases". Ajo pohon që ka pasur sinjale specifike që personat queer të gjejnë njëri-tjetrin në media sociale dhe kështu të formojnë rrethe dhe grupe të sigurt shoqërie. Sipas saj kjo ka sjellë shumë anë pozitive si të ndjerit i validuar, ndihma në çdo qështje lidhur me të qenët pjesë e komunitetit, si dhe ndjenja e të qenët të pavarur nga normat sociale. Në media sociale Marigona është munduar të ofrojë këshilla dhe mbështetje për çdo person queer që ka ndeshur me llogaritë e saj, si tentim të rikrijojë pranimin që ka pasur vetë drejt komunitetit dhe personave queer të tjerë.

Megjithatë, disa prej tyre shprehin shqetësime rreth ndikimeve negative të rrjeteve sociale. Algoritmet që drejtojnë këto platforma shpesh promovojnë përmbajtje brenda një grupi të kufizuar përdoruesish, duke arritur kryesisht tek ata që tashmë janë të informuar dhe mbështetës të komuniteteve. Kjo kufizon ndikimin edukativ te

individët që kanë më së shumti nevojë për të kuptuar dhe pranuar personat queer. Për më tepër, hapësira virtuale që mundëson fshehjen e identitetit shpesh shndërrohet në një mjedis ku fenomeni i cyberbullying është i përhapur, duke polarizuar edhe më tej diskursin rreth komuniteteve. Pjesëmarrësit vlerësojnë se rrjetet sociale shpesh krijojnë një jetë të dyfishtë për anëtarët e komuniteteve LGBTI+. Kjo jetë virtuale lejon një shprehje më të lirshme dhe autentike të identitetit të tyre, në kontrast me atë se si janë të detyruar të paraqiten në jetën reale për të shmangur paragjykimet dhe rreziqet. Ky dualitet, ndërsa ofron një hapësirë për vetë-shprehje, gjithashtu thekson sfidat e vazhdueshme me të cilat përballen komunitetet në përpjekjet për pranimin e plotë shoqëror.

Sa i përket anës negative Eris shpreh mendimin e saj si që deri tani nuk ka pasur reprezentim të duhur të personave queer në media. Këtu shpreh se ka njerëz të ndryshëm jo kompetent që shpërndajnë keqinformata aq të rënda për komunitetet si mjekë duke quajtur të qenët queer një sëmundje mendore. Tjetër reprezentim negativ sipas saj është kur gjithmonë në debate rreth temave queer thirren personat e gabuar që vetëm se konfirmojnë idetë fillestare të gabuara të audiencës duke i dhënë atyre akoma më shumë bazë.

Melosi gjithashtu shprehet se përballja me bullizëm është më e vështirë online ku të gjithë kanë qasje dhe mund të shprehin homofobinë dhe gjuhën urrejtëse duke qëndruar anonim, dhe kjo mund të jetë e rëndë për personat që hynë në internet për të gjetur më shumë informata për seksualitetin e tyre dhe në fakt është një nga "rrjetet e para" të gjetjes së vetës por përballen me këto lloj ofendimesh vetëm sepse ekzistojnë. Në rrjetet sociale, ku ka shumë persona të cilët qëndrojnë anonim e shohin botën virtuale si të vetmën hapësirë të sigurtë, ku në grupe private në rrjete sociale si

Facebook më e shpeshta për moshat 30-40+, ata gjejnë persona me të cilët ndihen të lidhur, kjo shpesh mund të kthehet e rrezikshme për ta për shkak të "jetës së dyfishtë", për shkak të shantazhimit, për shkak të kërcënimeve me vdekje dhe për shkak të frikës së shkatërrimit të familjes.

"[Rrjetet sociale] a ndikojnë te këta boomers, te gjeneratat ma t'vjetra e këta të gjeneratës tem që e ngojnë Andrew Tate, jo nuk ndikon hiq. Ata ja bojnë report këtij contenti. Nashta edhe hiç s'ju del, se algoritmat funksionojnë n'qat mënyrë që mu ka me ma qit komunitetin në for you page, atyne nuk ja u qet. Atyne ja u qet qesi thënie për ego e sene të ngjashme." [Dea]

Aktiviz(i)mi si mjet edukativ dhe burim i përballjes

Pjesëmarrësit përgjatë tërë intervistimit përmendin rëndësinë që ka mobilizimi i aktivistëve për të avokuar për komunitetet. Kjo mund të jetë sepse përjashtimisht institucioneve shtetërore, në Kosovë përmes organizatave të shoqërisë civile shumë njerëz iu ekspozohen ideve alternative dhe kërkesave të komuniteteve. Të gjithë pjesëmarrësit, në një mënyrë apo tjetër kanë qenë të angazhuar në shoqëri civile dhe kjo duket se i ka formësuar besimet e tyre drejt intervenimeve që këto organe mund të ofrojnë në raport me visibilitetin. Përveç aktivizmit si mjet edukues, pjesëmarrësit e shohin aktivizimin edhe si burim i përballjes me një realitet që është shtypës në thelb. Janë aktivistët që lënë përshtypje dhe duket se disa figura kanë pushtet më të madh në arritjen e qëllimit.

Melosi kur rikujton vitet e universitetit, reflekton se kanë qenë një ndër gjeneratat e para që kanë folur për tema queer, duke potencuar që njëra ndër format se si kanë marrur më së shumti informata ka qenë përmes organizatave:

"Gjatë vitit 2013 ka qenë shumë e vështirë që të shihje ose dëgjoje për tema queer. [...] Njoftimi dhe edukimi më shumë për temat queer ka qenë e mundur vetëm nëse ke qenë pjesë e organizatave joqeveritare."

Besniku gjithashtu përmend aktivizmin si njëra prej arsyeve pse Prishtina është aq atraktive për komunitetet, duke qenë vatër e lëvizjeve të ndryshme dhe sasisë së madhe të informacioneve:

"Tash ka vene kogjo; ki kafe t'mira, ki bars t'mirë, ka OJQ që mirren specifikisht, osh t' CEL-i, Dylberizmi është ni platformë kogjo nice, edhe plotë të tjerë që mujnë me mbledh komunitetin." Arsyja që jena mirr shumë me OJQ e të tjera [mund me qenë] se na jem' ven' i vogël, prej ku vijmë edhe ka pasë pak mundësi me u kap në qeto tema. Po për shkak që na jena anu ma shumë kah kryeqyteti [edhe ju kemi ekspozu ma shumë kësaj fryme]."

Për të gjithashtu aktivizmi i personave jo-queer ka rëndësi të madhe:

"P.sh. në momentin kur u diskutu në shkollë të mesme ose diçka, s'ke mujt me u kanë i vetmi individ që ke argumentu pro edhe pro edhe pro se ndryshe...kur të djeg ni temë, ti vërehesh. Amo kur i ke pasë individë të tjerë, [...] sidomos janë non-queer people [ata që ndihmojnë], se çdoherë e ki besoj ma t'lehtë me thanë fjalë për ni komunitet tjetër. Diqysh ti thjeshtë nuk je qashtu, edhe ti munesh me mbështet fuqishëm edhe furishëm pa u ni i kërcënum, se edhe nëse t'a bon dikush "hajt se edhe ti je qashtu" nuk të djeg, edhe ti i thu "po, jom, edhe?"." [Besniku]

Eris sheh aktivizmin si një prej mënyrave se si arrin të pranojë veten. Ajo nuk ka qenë gjithmonë pjesë aktive e komunitetit. Ajo e ndjen vetën që ka shkuar në një farë mënyre valë-valë

duke mos pasur aktivitet konstant në komunitet për shkak të frikës ndaj urrejtjes që do të marrë nga shoqëria. Vitin e kaluar ajo ka xhiruar një dokumentar ku vetëm se shprehet për jetën e saj si një grua queer në Kosovë, e cila e fuqizoi edhe më tepër për t'u marrur me veprimtari të tjera relevante.

Marigona gjithashtu i shton rëndësi aktivizmit, sidomos kur ajo vjen prej figurave prominente, siç janë artistat dhe muzicentët e famshëm, të cilët marrin guximin të dalin haptazi. Kjo bën që njerëzit dalë-ngadalë në mënyrë disi të pavetëdijshme të marrin të qenët pjesëtar i komuniteteve si diçka 'normale' dhe jo aq ndryshe. Nxitja e vetëdijësimit sipas saj heq stigmën rreth komuniteteve. Marigona rolin e saj e sheh si të një personi i cili mund të jetë mentore për të tjerët rreth eksplorimit të seksualitetit të tyre, duke ofruar mbështetje emocionale e sociale, dhe duke i udhëzuar kurdo që kanë nevojë. Këtë lloj të aktivizmit ajo e konsideron si burim i fuqishëm i ndërtimit të harmonisë kolektive dhe krijimit të një përkatësie brenda-përbrenda komuniteteve.

Ndryshimi fillon nga vetja: rekomandime

Pjesëmarrësit shprehin se përmirësimi i pozitës së komuniteteve LGBTI+ në Kosovë kërkon masa të shumanshme, duke filluar nga reformat në sistemin edukativ deri te përmirësimi i mbrojtjes ligjore. Megjithatë, pjesëmarrësit vlerësojnë se kjo është një rrugë e gjatë, duke pasur parasysh strukturën konservatore të shoqërisë kosovare. Një aspekt tjetër që konsiderohet kritik është mbrojtja ligjore. Ligjet që mbështesin të drejtat e komuniteteve LGBTI+ janë parë si një parakusht për të siguruar që shqetësimet e tyre të merren seriozisht nga institucionet dhe publiku i gjerë.

"Si sugjerim mund të jenë që përveç ndryshimeve

sistematike që duhen, hapi parë do të ishte ndryshimi i kurrikulës në më gjithëpërfshirëse, ku fëmijët do të ekspozohen ndaj personave queer përmes shembujve të thjeshtë në libra dhe përmes ilustrimeve. Repezantimi në libra do të jetë e rëndësishme për personat që mund të jenë queer dhe që janë duke gjetur vetën.” [Melosi]

Disa rekomandime që Eris lë për të tjerët në lidhje me komunitetet janë implementimi i edukimit seksual nëpër shkolla fillore, ku spjegohet dhe për identitetin gjinor dhe atë seksual si dhe përmirësimi dhe përditësimi i informatave në lidhje me këto tema në mënyrë konstante.

Ndërkohë, dëshira më e madhe e pjesëmarrësve është që seksualiteti të shihet thjesht si një aspekt i zakonshëm i diversitetit njerëzor, pa u shoqëruar me stereotipe apo diskutime të zgjatura. Ata ndihen të lodhur nga nevoja për të arsyetuar ekzistencën dhe të drejtat e tyre, një barrë që i rëndon emocionalisht.

“Nuk është ideja që gjenerata jonë me u ni safe, është që gjenerata tjetër me u ni safe. [...] Ti nuk munesh me normalizu të të qenët queer—gjë që është normale—tu e shpejtu si proces. You need time, specifikisht me shoqinë me të cilën ka të boj. Është ide shumë e re, edhe informacionet edhe senet duhet me hi tepër kadal. Në momentin që ni njeri diskuton shumë për diçka, ajo stërkonsumohet. Qetu o çështja, që diskutohet shumë, se na nuk diskutojmë qekaq shumë about being straight, edhe kur ti nuk diskuton për diçka, that thing is normal [...] Normalizim te unë është një shoqni utopike, ku nesër ti je ul edhe vjen ni profesor i joti edhe thotë "okej, klasa hajde t'a përmbledhim qet' temë se po m'pret burri jashtë", edhe thu "bruh?! This person is gay??" amo he doesn't scream që unë jom qeshtu. Veç me u kanë. Nuk munesh me normalizu domethanë t'u bo zhurmë, e

normalizon tu e normalizu.” [Besniku]

Një rekomandim i theksuar nga pjesëmarrësit është përfshirja aktive e individëve, qofshin pjesëtarë të komuniteteve apo aleatë, në procesin e edukimit të gjeneratave të reja. Ata besojnë se ndihma për të rritur një brez që nuk mbart paragjykimet e të kaluarës është një hap i rëndësishëm drejt ndryshimit. Mirëpo këtë e presin më shumë në përmirësime individuale sesa transformime të mëdha strukturore në të ardhmen e afërt.

Rekomandim i Marigonës për të ardhmen është që secili nga ne të mundohemi në mënyrë aktive të çrrënjoshim çka është mësuar ndër vite, normalizimi i personave queer në shoqëri si diçka e pashmangshme dhe ekzistente me vite, përditësimi i kulturës në një mënyrë që t’iu përshtatemi normave bashkëkohore për të mirën e njerëzimit si dhe mësimi i gjeneratave të reja të jenë më tolerant dhe mbështetës.

“Unë muj me u zotu që fëmin’ tem ka me e pranë qysh osht’, edhe menoq që motrat e mia t’paktën për qaq sa kam njohuri i pranojnë fëmijët e vetë qashtu. Edhe te vëllau jem muj me pasë nifarë ndikimi që mos me e bullizu personin tjetër për që është. Qeto janë ndryshimet që mundemi me i bo, secili person queer me ndiku te familjet e veta, ose te gjeneratat e reja ma shumë, te rrethi i vetë.” [Dea]

Diskutimi

Ky studim ka eksploruar eksperiencat dhe përjetimet që kanë personat që identifikohen të jenë pjesë e komuniteteve LGBTI+ në Kosovë. Këto eksperiencat prekën sfera të ndryshme të jetës si sociale, ekonomike, shëndetësore, personale etj.. Gjetjet e studimit janë në përgjithësi konsistente me literaturën dhe studimet e mëherëshme të bëra me pikërisht këtë temë.

Sa i përket temës së gjetur, "Prishtina si hapësirë që ofron mundësi të shumta për komunitetin" bashkëbiseduesit raportuan që shpërngulja në Prishtinë ishte një hap pozitiv për ta si persona queer pasi që pranueshmëria është më e lartë. Për këtë nuk pati studime në kontekstin kosovar që mbështesin mirëpo gjithësesi ka literaturë që mbështet gjetjen që qytetet më urbane ofrojnë hapësirë më pranuese për komunitetet. Doderer (2011), thekson në esenë e saj që jeta në qytet sfidon idetë preekzistuese rreth gjinisë që ndikon pozitivisht në komunitetet LGBTI+. Për më tepër ajo (po aty) konstaton që qytetet ofrojnë kushtet e nevojshme që personat LGBTI+ të shprehin haptazi identitetin e tyre si dhe të organizohen kolektivisht për një vizibilitet dhe fuqizim më të lartë te komunitetet.

Përgjatë literaturës, në kundërshtim me gjetjet e këtij studimi, mbështetja institucionare shtetërore nuk duket të jetë aq e rëndësishme për mirëqënien e personave queer sa aspekte tjera mbështetëse. Deana Morrow (1993) cek se si suporti social është i nevojshëm për adoleshentët homoseksualë mirëpo nuk vë peshë të madhe tek institutet shtetërore. Kjo mund të jetë për shkak se për dallim nga shtetet perëndimore, në Republikën e Kosovës mungesa e

mbështetjes institucionale e invalidon procesin e njohjes, duke qenë që korniza kulturore ka tendenca të jetë kolektivistike hierarkike, dhe si e tillë i vendos komunitetet direkt në një pozitë kërcënimi. Studimi i Telljohann dhe Price (1993) gjithashtu, tek tema që ata gjetën “Ata që ishin ndihmues”, tregon që suportin më të madh personave queer u ofron shoqëria (zakonisht queer vetë), grupet mbështetëse si dhe familjarët (shumica nënat apo ndonjë vëlla/motër). Kjo literaturë gjithashtu lidhet me një tjetër nga temat që është “Mbështetja nga rrethi social si lehtësues i procesit të rrëfimit”. Në këtë studim shumica e bashkëbiseduesve ishin pranuar mirë nga rrethi dhe shoqëria, e shpreheshin se kjo ishte mbështetja më e madhe që kishin marrë. Përkundër kësaj përkrahje, mosmbështetja nga institucionet arsimore dhe shëndetësore duket të jenë evidente si në hulumtimin aktual, ashtu dhe në literaturë preekzistuese. Sa i përket sistemit shëndetësor, studimi i Natyra Avdiut (2016), vë në pah se si profesionistë shëndetësorë në vendin tonë nuk janë dakord me operacionet gjini-afirmuese, aq shumë sa që quajnë këtë devijim mendor. Në të njëjtin studim (Avdiu, 2016) një nga të intervistuarit thotë “nuk kemi nevojë me i mbështet, ne i injorojmë ata, sepse ata janë njerëz të ultë, ata janë për psikiatri” kur pyeten për rolin e tyre si shtyllë mbështetëse për komunitetet. Kjo bie në vijë me gjetjet e këtij studimi ku pohohet se sistemi shëndetësor ofron tejet pak mbështetje.

Një temë tjetër shumë prominente është “Ambiguitetit: nga vetë-urrejtja deri te vetë-pranimi”. Pjesëmarrësit tregojnë si edhe pse kanë qenë vetë aleatë dhe përkrahës të komuniteteve, ndjenin një ndjenjë homofobie ndaj vetes së tyre. Kjo temë del të jetë konsistente me literaturë. Studimi i O’Connell (2011) me temë homofobinë e internalizuar, hedh në pah këtë eksperiencë të ndarë mes personave LGBTI+. Disa nga të intervistuarit e tij thonë të kenë krijuar një formë të

urrejtjes ndaj vetëvetes shkaku i seksualitetit mirëpo jo urrejtje ndaj seksualitetit si të tërë. Duke mbështetur këtë edhe studime tjera tregojnë se si personat queer shprehin më shumë tolerancë për grupet jo konvencionale dhe të marginalizuara se personat jo queer, por prapë mbajnë rezerva për pranim të plotë personal (Corbett et al., 1977). Studimi i Rowen dhe Malcolm (2003) tregon se homofobia e internalizuar është e ndërlidhur me formim të identitetit seksual dhe vetëvlerësim më të ulët si dhe shkallë më të lartë të ndjenjës së fajit rreth mardhënieve seksuale gjë që u raportua dhe nga respondentët tanë.

Të të intervistuarve shprehën si stigma dhe gjuha e urrejtjes ishte diçka që ata kishin hasur si person queer në Kosovë. Dhe në literaturë stigma duket të jetë një pjesë e pandarë e të qenët queer në ditët e sotshme. Hulumtimi mbi gjuhën e urrejtjes që synon homoseksualët dhe individët e tjerë LGBTI+ zbulon ndikime signifikante psikologjike dhe fiziologjike. Ekspozimi ndaj gjuhës homofobike të urrejtjes mund të ulë mirëqenien, veçanërisht në mesin e atyre që identifikohen fuqishëm me komunitetet LGBTI+, duke ndikuar në disponimin dhe kënaqësinë e jetës (Zochniak et al., 2023). Gjithashtu dhe paralelizimi me figura keq-bërëse është temë e përbashkët e shprehur në studim dhe atë të Telljohann (1993) ku njëri nga pjesëmarrësit e tij shprehet të jetë konsideruar si “bishë barbare nga ferri” në momentin që ka dalë jashtë si person i komuniteteve. Një tjetër pjesëmarrës në po të njejtin studim (po aty) preku dhe temën e religjionit duke thënë se nëna e tyre shprehi shqetësime për konflikte fetare, gjë që u përmend dhe nga respondentët tanë.

Një nëntemë e kësaj teme dol të jetë fetishizimi i lezbikeve dhe përjashtimi i burrave queer. Nga literatura shohim se dallimet në qëndrimet e meshkujve ndaj

homoseksualëve të secilës gjini shtrihen përtej dëshirueshmërisë tradicionale shoqërore. Louderback dhe Whitley (1997) gjetën se burrat u raportuan të vendosnin vlerësime shumë më të larta erotike në sjelljen seksuale të të njëjtit seks të femrave sesa në sjelljen seksuale të të njëjtit seks të meshkujve. Duke mbështetur gjetjet e këtij studimi që këtë akt bënin meshkujt më shumë, i njëjti studim gjeti se gratë u raportuan të vendosnin vlerësime të barabarta (dhe jo shumë tërheqëse) për aktivitetin seksual qoftë mes lezbikeve apo mes burrave gej.

Një temë tjetër që ka dalur nga gjetjet është mediat sociale si një medalje me dy anë. Pra të intervistuarit treguan se si mediat sociale luajnë rol pozitiv por njëkohësisht dhe negativ në shoqërinë tonë sa i përket qështjeve lidhje me komunitetet LGBTI+. Dhimman (2023) pohon ekzaktësisht këtë duke thënë “Këto platforma kanë lejuar individët të shprehin identitetin e tyre, të lidhen me të tjerët dhe të gjejnë mbështetje. Megjithatë, ata gjithashtu kanë ekspozuar individë ndaj gjuhës së urrejtjes, diskriminimit dhe bullizmit në internet” që drejtpërdrejtë thotë atë që implikuan dhe pjesëmarrësit e këtij studimi. Është vështirë të vendosim se cila anë ka peshë më të madhe, por fakti që mediat sociale kanë anë pozitive dhe negative njëkohësisht është i pamohueshëm.

Në përgjithësi gjetjet mbështeten nga literatura ekzistuese dhe ofrojnë të dhëna më të gjera dhe për kontekstin kosovar. Rekomandimet nga të intervistuarit janë nga më të ndryshmet duke përfshirë ofrimin e informatave në institute shkollore, mbrojtja ligjore, etj.. Më të rëndësishmen ata veçuan të jetë që secili nga ne, aleatë apo pjesë e komuniteteve vetë, të bëjmë një hap drejt ndryshimit. Mënyra më e mirë sipas tyre të bëjmë këtë është duke edukuar gjeneratat e reja në mënyrë që të mos rriten diskriminues

ndaj të tjerëve me shpresa që do të ketë një ndikim të gjerë në shoqëri në dekadat me rradhë. Potencohet pjesa “në dekadat me rradhë” pasi që ata nuk kishin pritshmëri që ndryshimet të ndodhnin në një afat të shkurtë kohor pasi që Kosova sipas tyre ka nevojë për një ndryshim sistematik.

Ky studim ofron një pasqyrë të përjetimeve të komunitetit queer në kontekstin e një shteti konservator ballkanik, siç është Kosova, dhe si i tillë shtron terrenin për studime të ardhshme. Disa nga kuifizimet e studimit mund të llogariten mungesa e një hapësire të qetë për të mbajtur intervistat në disa raste, që mund të kenë influencuar të dalurat nga studimi. Për më tepër, mostra e studimit përfshin persona që identifikohen në dimensionet e homoseksualitetit dhe biseksualitetit, duke mos përfshirë persona transgjiorë, pikëpamjet e të cilëve/ave mund të jenë më ndryshme. Edhe pse disa tema u eksploruan nga ky kërkim, për studiuesit e ardhshëm rekomandohet thellimi në temat e përmendura, potencialisht me fokus në fusha të caktuara me theks të veçantë në sistemin arsimor dhe organet qeveritare në ofrimin e shërbimeve afirmative për komunitetet. Ky studim mund të përdoret si një vlerë e shtuar e arkivit thuajse jo-ekzistent të hulumtimeve queer në Kosovë. Sugjerohet gjithashtu të ekplorohen perspektiva më të larmishme përbrenda komuniteteve LGBTI+ duke përfshirë individë transgjiorë dhe/ose individë që veshin etiketime të tjera brenda ombrellës queer. Për më tepër, studimet kuantitative janë të mirëpritura për të parë më objektivisht efektet e ndryshme që vështirësitë e përmendura shkaktojnë në mirëqenien e pjesëtarëve të komuniteteve.

Referencat

American Psychological Association. (2017). *Ethical principles of psychologists and code of conduct* (2002, amended effective June 1, 2010, and January 1, 2017).

<https://www.apa.org/ethics/code>

Asakura, K. (2016). Paving pathways through the pain: A grounded theory of resilience among lesbian, gay, bisexual, trans, and queer youth. *Journal of Research on Adolescence*, 27(3), 521–536. <https://doi.org/10.1111/jora.12291>

Avdiu, N. (2016). *Mbrojtja sociale dhe qasja në kujdesin shëndetësor për personat transgjinorë në Kosovë*. CSGD & CEL.

https://cel-ks.org/wp-content/uploads/2023/08/Transgender-Report_ALB.pdf

Barrita, A. M., & Wong-Padoongpatt, G. (2021, December 1). *Resilience and Queer People*.

https://doi.org/10.1163/9789004506725_118

Corbett, S. L., Troiden, R. R., & Dodder, R. A. (1977). Tolerance as a Correlate of Experience with Stigma: *Journal of Homosexuality*, 3(1), 3–14. doi:10.1300/j082v03n01_01

Clandinin, D. J. (2006). Narrative inquiry: A methodology for studying lived experience. *Research studies in music education*, 27(1), 44–54.

De Lauretis, T. (1991). Queer theory: Lesbian and gay sexualities, an introduction. *Differences: A Journal of Feminist Cultural Studies*, 3(2), iii–xvii.

Dhiman, B. (2023). *Impact of Social Media Platforms on LGBTI+QA+ Community: A Critical Review*.
<https://nbn-resolving.org/urn:nbn:de:0168-ssoar-87501-6>

Doderer, Y. P. (2011). LGBTI+Qs in the City, Queering Urban Space. *International Journal of Urban and Regional Research*, 35(2), 431–436. doi:10.1111/j.1468-2427.2010.01030.x

Estefan, A., & Roughley, R. A. (2013). Composing self on narrative landscapes of sexual difference: A story of wisdom and resilience. *Canadian Journal of Counselling and Psychotherapy*, 47(1), 29–48.

Hajdari, E., Krasniqi, A., & Ömer, İ. (2022). Same-sex relationships: The absence of legislative framework in the Republic of Kosovo. *International Comparative Jurisprudence*, 8(1), 48–59.
<https://doi.org/10.13165/j.icj.2022.06.004>

Kadriu, E. (2022). *“Nuk e dimë qysh është me qenë të lirë” - K2.0. Kosovo 2.0*.
<https://kosovotwopointzero.com/nuk-e-dime-qysh-eshte-me-qene-te-lire/>

Louderback, L. A., & Whitley, B. E., Jr. (1997). Perceived erotic value of homosexuality and sex-role attitudes as mediators of sex differences in heterosexual college students' attitudes toward lesbians and gay men. *Journal of Sex Research*, 34, 175–182.

McCann, E., & Brown, M. (2016). Discrimination and resilience and the needs of people who identify as transgender: A narrative review of quantitative research studies. *Journal of Clinical Nursing*, 26(5–6), 1–16. <https://doi.org/10.1111/jocn.1391>

McDermott, E., Eastham, R., Hughes, E., Pattinson, E., Johnson, K., Davis, S., ... Jenzen, O. (2021). Explaining effective mental health support for LGBTI+ youth: A meta-narrative review. *SSM - Mental Health*, 1, 100004. doi:10.1016/j.ssmmh.2021.100004

Mizzi, R. C. (2014). Troubling preparedness: Investigating the (in)visibility of LGBTI+ concerns within pre-departure orientations. *Development in Practice*, 24(2), 286–297. [https://doi.org/10.1080/09614524.2014.885493`](https://doi.org/10.1080/09614524.2014.885493)

Morrow, D. (1993). Social Work with Gay and Lesbian Adolescents. *Social Work*. doi:10.1093/së/38.6.655

National Democratic Institute (2015). *NDI Public Opinion Poll in the Balkans on LGBTI+ Communities*. SlideShare; Slideshare. <https://www.slideshare.net/slideshow/ndi-public-opinion-poll-in-the-balkans-on-LGBTI+-communities/54495638>

O'Connell, J. (2011). *An exploration of the experience of internalised homophobia among gay Irish men: a phenomenological approach*. <https://esource.dbs.ie/server/api/core/bitstreams/2ebb4fa1-2e79-4ac1-b138-b62b44a7e209/content>

Rowen, C. J., & Malcolm, J. P. (2003). Correlates of Internalized Homophobia and Homosexual Identity Formation in a Sample of Gay Men. *Journal of Homosexuality*, 43(2), 77–92. doi:10.1300/j082v43n02_05

Telljohann, S. K., & Price, J. H. (1993). A Qualitative Examination of Adolescent Homosexuals' Life Experiences. *Journal of Homosexuality*, 26(1), 41–56. doi:10.1300/j082v26n01_04

Watson, K. (2005). *Queer Theory*. *Group Analysis*, 38(1), 67–81.
doi:10.1177/0533316405049369

Zochniak, K., Lewicka, O., Wybrańska, Z., & Bilewicz, M.. (2023). Homophobic Hate Speech Affects Well-Being of Highly Identified LGBTI+ People. *Journal of Language and Social Psychology*, 42(4), 453–463.
<https://doi.org/10.1177/0261927x231174569>

Shtojca A

Udhëzuesi Tematik

Përshëndetje, fillimisht ju falenderoj edhe njëherë që keni pranuar për të marrur pjesë në hulumtim. Hulumtimi jonë siç e dini ka për qëllim të eksploroj përvojat e personave queer në Kosovë në ballafaqim me kulturën, sistemet, dhe jetën në Kosovë. Është e rëndësishme për ne të kuptojmë më shumë rreth jetës tuaj sa i përket zhvillimit të identitetit gjinore dhe/ose seksual, andaj ju inkurajojmë që të merrni kohën tuaj dhe të mos kurseni për dhënien e përgjigjeve. Çdo koment i juaji ka rëndësi dhe ne jemi këtu për të dëgjuar storjen tuaj. Atëherë do të fillojmë intervistën.

[Për audio-inçizimin deklaroni: Data, Numri i Intervistës]

1. A mundeni me na tregu rreth juve, kush jeni, si identifikoheni? [Përemrat]

Përvojat personale me identitetin queer:

2. Kur dhe si e keni kuptuar që jeni ndryshe nga pritshmëritë sociale për orientimin ose identitetin seksual? Si ka qenë përvoja juaj me rrëfimin dhe daljen nga dollapi?

Përballimi i traumës kolektive dhe ndërtimi i reziliencës:

3. Si keni përjetuar dhe përballuar gjuhën e urrejtjes dhe dhunën ndaj komuniteteve queer në një shoqëri konservative si Kosova? Çfarë ju ka ndihmuar të qëndroni të fortë dhe për t'u përballuar me situatën?

4. A jeni ndjerë i/e përjashtuar nga disa grupe apo komunitete?

Ndjenja e përkatësisë në komunitete:

5. Si ka qenë përvoja juaj me krijimin e raporteve dhe aleancave në komunitetin queer? Sa të qasshme kanë qenë hapësirat e komuniteteve për ju?

Roli i kulturës dhe rrjeteve sociale:

6. Si e shihni rolin e rrjeteve sociale dhe kulturës kosovare në edukimin e publikut dhe krijimin e qëndrimeve afirmative për përvojat e komuniteteve queer?

Përvojat me sistemet qeveritare dhe rekomandimet për ndryshim:

7. Cilat kanë qenë përvojat tuaja me sistemet qeveritare dhe çfarë mendoni që duhet bërë për të ulur stigmatizimin dhe për të rritur pranueshmërinë e personave queer?

Shtojca B

Libri i kodeve

Etiketimi/Kodifikimi	Shpjegimi	Shembull
Aktivizmi	Impakti i lëvizjeve të OSHC-ve dhe prëfshirja e pjesëmarrësve.	5:2 "Gjatë vitit 2013 ka qenë shumë e vështirë që të shihje ose dëgjoje pë..."
Komunitetet LGBTI+	Ndihma e ofruar nga përkishtëria me komunitetet	2:13 "Këto viteve të fundit është hapur kafeneja e parë në Prishtinë e dedikuar..."
Përballja	Mekanizmat që kanë përdorur pjesëmarrësit për t'u përballuar me vështirësitë.	4:10 "P.sh. ni sen çka menoj që ka lu rol tepër të madh, osht' pjesa akadem..."
Fetishizimi & Përrjashtimi	Fetishizimi i grave queer dhe përrjashtimi i burrave queer.	4:10 "P.sh. ni sen çka menoj që ka lu rol tepër të madh, osht' pjesa akadem..."
Rrëfimi	Informata rreth procesit të të dalurit nga dollapi	2:1 "Ajo shpjegon se si është ndërë gjatë tërë jetës e tërhequr nga vajzat..."
Mbështetja Institucionale: Edukimi	Informata rreth sistemit arsimor sa i përket komuniteteve.	5:12 "[Sistemet shtetërore] kanë qenë jashtëzakonisht homofobike, shumica "...

Mbështetja Institucionale: Shëndeti	Informata rreth sistemit shëndetësor sa i përket komuniteteve.	1:15 "Eksperienca që e kom pasë unë është me një psikologe, (...) pata vendos..."
Mbështetja Institucionale: Aksionet	Veprimtaritë institucionale në përkrahje të komuniteteve.	4:13 Përderisa në raport me të kaluarën visibiliteti i komunitetit është më...
Etiketimi i kufizueshëm	Përmendja e etiketimit si diçka që kufizon identitetin e tyre.	3:6 "Kur jom rritë... domethënë unë krejtë shokëve i kam thonë 'hej a din i'..."
Dalja në Prishtinë	Përshtypjet e ekspozimit me mundësitë që ofrohen në Prishtinë	2:14 "Duke qenë e ardhur nga një qytet tjetër i Kosovës, ajo tregon për forc..."
Rekomandimet	Mundësitë e intervenimit, dhe pikëpamja mbi të ardhmen e komuniteteve.	2:18 "Ajo tregon që ndryshimi tani për tani është duke ndodhur në suaza indi..."
Rrjetet sociale: Pozitive	Pikëpamjet pozitive për rrjetet sociale.	1:9 Pas kësaj ajo vec se kishte konfirmuar në një pikë frikën e saj, pasi...
Rrjetet sociale: Negative	Pikëpamjet negative për rrjetet sociale.	2:15 "Mediat sociale menoj që ndihmojnë, i ofrojnë platformë komunitetit me..."
Stigma	Stereotipet mbi komunitetet.	2:10 Në grupe të vogla, kur konfrontimi iu implikohet nga më pak persona, a...

Dhuna	Shtypja direkte e komunitetet.	2:6 "Recently e kom pa ni tiktok që thotë "the devil couldn't reach me so..."
Vetë-urrejtja	Keqpërballimi me identitetin	2:4 "kaniherë e pyes veten shumë" dhe e kap një lloj turpi ndaj ndjenjave...
Vetë-pranimi	Rregullimi me identitetin	1:6 "(...) Seni ma së shumti që më ka menu- që më ka nimu mu është qajo ëëë.....